



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 391/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerim Grainca nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

#### VENDIM

- I. **Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerim Grainca nga radhët subjektivit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektivit politik LDK në Vendvotimin (VV) 2532/01R.
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 619.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektivit politik LDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit të fletëvotimeve është konstatuar se ka 68 vota në VV Nr. 2532D/01R, dhe me rastin e plotësimit të FRK-së numri i këtyre votave është shënuar tek kandidata tjetër e radhës me numrin 75, dhe se ky rezultat figuron në rezultatin final në KQZ.

Parashtuesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e anëtarit të komisionit të QV nr. 2532D/01R.

Në nenin 117. 2 të LZP-së është paraparë: *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”, andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:*

## **ankesa është e bazuar.**

PZAP-i, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Blerim Grainca nga subjekti politik LDK, dhe në këtë drejtim në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për të bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i 68 votave në FRK nga ana e komisionarëve të VV nr. 2532D/01R dhe bartja e votave të tij tek kandidatja me numër 75.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit nr. 2531D/01R për Komunën e Ferizajt ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 135156, 113841, 135157 dhe 135158 ndërsa shiriti i mesëm nr. 135155 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti brenda kutisë së votimit kishte nr. 1351160.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me numër 76 nga radhët e subjektit politik LDK nuk posedon asnjë votë, ndërsa pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutinë e votimit 2532D/01R del se janë 12 fletëvotime të vlefshme të kandidatit në fjalë.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe nga deklarata e anëtarit të KVV sipas të cilit është bërë gabim i paqëllimshëm gjatë plotësimit të FRK-së në QV 2531D/01R në Komunën e Ferizajt, del se ka pasur një lëshim gjatë plotësimit të FRK-së në VV e cekur më lartë, me ç'rast numri i votave të kandidatit Blerim Grainca nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së

Nga këto arsye e me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura, është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 391/2014 më datën 30.06.2014



#### **Udhëzim Juridik:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*